



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

TERMAT E REFERENCËS

Ekspert i Jashtëm për Vlefshmërinë Ajrore

Autoriteti i Aviacionit Civil është autorizuar të kontraktojë një këshilltar të përshtatshëm teknik të kualifikuar për të kryer detyrat e konsulentit të vlefshmërisë ajrore. lidhur me regjistrimin, certifikimin dhe mbikëqyrjen e avionëve, vlerësimin dhe miratimin e Organizatave të menaxhimit të vlefshmërisë ajrore dhe të mirëmbajtjes, si dhe rishikimin e përmirësimit e procedurave të brendshme të sektorit të vlefshmërisë ajrore dhe mirëmbajtjes.

Qëllimi

Qëllimi i konsulencës është dhënia e shërbimit të konsulencës dhe pjesëmarrjes në proces në drejtim të lëshimit të COA për operatorët e rinj për sa i përket menaxhimit të vlefshmërisë ajrore dhe mbikëqyrjes së operatorëve ekzistues, në përputhje me kërkesat rregullatore të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Objektivi

Të ndjekë dhe të ofrojë një ekspertizë profesionale gjatë procesit të certifikimit të operatorëve ajrore, regjistrimit e certifikimit të avionëve e organizatave të menaxhimit të vlefshmërisë ajrore dhe mbikëqyrjes së tyre.

Detyrat

Konsulenti do të asistojë Sektorin e Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes në Drejtorinë e Mbikëqyrjes të Operatorëve Ajrorë dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Mbi bazën e një programi të detajuar asiston dhe merr pjesë në certifikimin e operatorëve të rinj që kanë aplikuar për marrjen e COA, për sa i përket organizimit të Menaxhimit të Vlefshmërisë Ajrore të operatorit (CAMO) si një kërkesë e domosdoshme në përbërje të COA;
- Asiston në vlerësimin e dokumenteve dhe në zbatimin e procedurave për regjistrimin dhe certifikimin e avionëve në kuadrin e marrjes së COA;

- Bën vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët lidhur me Organizatën e Menaxhimit të Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes dhe në zbatimin e procedurave për miratimin e tyre;
- Mbi bazën e planit të punës së miratuar të Sektorit të Vlefshmërisë Ajrore dhe mirëmbajtjes asiston dhe drejton auditet dhe inspektimet në kuadrin e mbikëqyrjes së këtyre organizatave;
- Bën OJT (On the Job Training) për inspektorët e marrë rishtas në punë, duke bërë vlerësimet përkatëse;
- Në kuadrin e ndryshimeve të fundit të Rregullave të Vazhdimësisë së Vlefshmërisë Ajrore, do të bëjë rishikimin e Manualit të Stafit Inspektues të vlefshmërisë ajrore dhe Mirëmbajtjes;
- Përpilon një program të detajuar pune lidhur me detyrat e mësipërme, të ndarë në fazat e realizimit të tij dhe produktet përbërës.
- Harton një relacion të detajuar të realizimit të detyrave dhe ja dorëzon përfaqësuesit të caktuar të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Autoriteti kontraktues do t'i sigurojë Ekspertit të gjithë informacionin/dokumentet e nevojshme për t'u njohur nga eksperti me qëllim përmbushjen e këtyre detyrave.

Periudha e zbatimit të detyrave:

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët.
Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 3 muaj.

Kualifikimet dhe aftësitë e konsulentit:

1. Të zotërojë diplomë master në fushën e inxhinierisë (aeronautike, mekanike, elektrike, elektronike, avionike).
2. Të ketë minimum 10 vjet përvojë pune në sektorin e aviacionit.
3. Të ketë njohuri të plota për legjislacionin në Aviacionin Civil Shqiptar dhe atë ndërkombëtar;
4. Të ketë eksperiencë në proceset e auditimit dhe inspektimit;
5. Të ketë eksperiencë në zbatimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë operationale (SMS).
6. Të njohuri dhe eksperiencë mbi sistemin e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të avionit.
7. Të njohë procedurat e mirëmbajtjes së avionit.
8. Të ketë eksperiencë për procedurat e certifikimit dhe mbikëqyrjes së organizatave të mirëmbajtjes dhe menaxhimit të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore, si dhe regjistrimit e certifikimit të avionëve.

9. Të jetë i trajnuar mbi parimet e faktorit njerëzor në aviacion;
10. Të ketë një shkallë të lartë integriteti, paanshmëri në kryerjen e detyrave.
11. Te ketë aftësi organizuese, të planifikojë dhe përmbush detyrat brenda afateve;

Produktet dhe materialet

- Eksperti përpilon një program të detajuar pune lidhur me detyrat e mësipërme, të ndarë në fazat e realizimit të tij dhe produktet përbërës.
- Harton një relacion të detajuar të realizimit të detyrave dhe ja dorëzon përfaqësuesit të caktuar të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Raportimi

- Eksperti do të raportojë në fund të çdo muaji mbi detyrat e realizuara në përputhje me ato të planifikuara në programin e punës, pranë përfaqësuesit të caktuar të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Dokumentacioni

Për të provuar kualifikimet dhe aftësitë, kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

- Letër shprehje interesi;
- Curriculum Vitae;
- Diplomë Universitare e Nivelit të Dytë;
- Certifikata trajnimi;
- Çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara.

Dorëzimi i dokumenteve

Kandidatët ftohen që të dërgojnë shprehjen e interesit dhe dokumentacionin e kërkuar brenda datës **24 Gusht 2018, ora 14.00**, në adresën:

Autoriteti i Aviacionit Civil
Rruga “Sulejman Delvina”, P.O. Box 205
Tiranë, Shqipëri